

# AKT - THEMELIMI



## I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR (VLLAZNIA NDERTIM) SH.P.K. BURREL

Ne Burrel sot me date 27.12.1995 ne te nenshkruarit Arben Çela I biri I Ramazanit dhe I Zenepes I datelindjes 1970 lindur ne Patin e banues ne Lagje Drita Burrel dhe Martin Pjetri I biri I Gjokes dhe Daves I datelindjes 1959 lindur dhe banues ne Lagje Drita Burrel me cilesine e ortakeve, vendosem me vullnetin tone te lire dhe te plote te krijojme shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar "Vllaznia Nderitm" Sh.P.K. Burrel.

### HYRJE

Ne kuptimin e ketije akti themelues, ortaket z.Arben Çela e Martin Pjetri jane themeluesit e shoqerise tregtare private "Vllaznia Nderitm" Sh.P.K. Burrel. Qellimi I ketije akti themelues eshte krijimi I shoqerise tregtare private "Vllaznia Nderitm" me qender ne qytetin e Burrelit dhe shtrirjen e saje ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise.

Shoqeria tregtare private "Vllaznia Nderitm" Sh.P.K. Burrel, rregullon veprimtarine e saje ne perputhje me Ligjin Nr. 7512 dt. 10 Gusht 1991, Kodin Tregtar ( Ligji 7638 dt 19 Nentor 1992 ) dhe aktet e tjera te legjislacionit Shqiptar.

Objekti I veprimtarise private te shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar "Vllaznia Nderitm" do te jete :

Ndertim-montim I objekteve te karaktereve dhe llojeve te ndryshme, import dhe export te lendeve te pare, materjaleve te ndertimit, makineri e paisje te ndryshme, te trajtimit te punetoreve, per tregtimin dhe prodhimin e artikujve me baze fibre, sintetike, xhami, hekuri, materjale inerte e ndertimi, artikuj industrial bimeve medicinale, investime ne fushen e turizmit, hapjen e lokaleve te tregtimit, ndertimin e dyqaneve, sipermarrjeve te ndryshme, krijimin e filialeve te ortakerive brenda dhe jashte vendit si dhe investime e aktivitete te tjera ne fushen e transportit

### AFATI I VEPRIMTARISE

Veprimtaria e kesaj shoqerie tregtare me pergjegjesi te kufizuar do te jete efektive nga dita e rregjistrimit ne rregjistrin tregtar, prane Gjykates se Rrethit Tirane, si dhe me paisjen me lejen e ushtrimit te profesionit privat nga organet kopetente.  
Aktiviteti privat I shoqerise tregtare "Vllaznia Nderitm" Sh.P.K. Burrel do te zhvillohet me nje afat te pacaktuar mbi 10 vjet,

STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "VLLAZNIA  
NDERTIM" SH.P.K. BURREL

Ne baze te Ligjit Nr. 7512 dt.10 Gusht 1991 "Per sanksionimin dhe mrojtjen e prones private, nismes se lire, veprimtarise private te pavarur dhe privatizimit", te Kodit Tregtar dhe te akteve te tjera ligjore, ne qytetin e Burrelit sot me date 27.12.1995 Ne ortaket Arben Çela dhe Martin Pjetri me banim ne qytetin e Burrelit me vullnetin tone te lire dhe te plote, ne perputhje me legjislacionin Shqiptar vendosem te krijojme shoqerine tregtareme pergjegjesi te kufizuar "Vllaznia Ndertim" Sh.P.K. Burrel.

KREUI I.

DISPOZITA TE PERGJITHME

Neni 1

Shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar "Vllaznia Ndertim" Sh.P.K. Burrel eshte person juridik I pavarur, ka te drejta dhe detyrime per te cilet pergjigjet brenda kufijve te percaktuar ne Ligjin 7512 dt 10 Gusht 1991, Kodin Tregtar, e aktet e tjera ligjore.

Neni 2

Shoqeria e ushtron veprimtarine e saje private ne baze te ekonomise se tregut te lire.

Neni 3

Themeluesit e shoqerise ne kete siper marrje kane derdhur kapitalin e tyre me qellim qe te perfitojne te ardhurat qe mund te vijne nga veprimtaria private si dhe te perballojne humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit ne kapacitetin fillestar.

Neni 4

Shoqeria tregtare private me pergjegjesi te kufizuar "Vllaznia Ndertim" Sh.P.K. Burrel, eshte person juridik dhe fiton zotesine per te vepruar me rregjistrimin e saje ne Gjykatën e rrethit te Tiranes dhe me paisjen me lejen e ushtrimit te profesionit nga organi kopetent.

EMERI - QENDRA - TERITORI

Neni 5

Emertimi I kesaj shoqerie do te jete : Shoqeria Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar "Vllaznia Ndertim" Sh.P.K. Burrel.



## Neni 6

Selia e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar "Vllaznia Ndertim" Sh.P.K.Burrel do te jete Lagje Pjeter Budi Burrel Me Nr. tel 775. Shoqeria mund te zhvilloje aktivitetin e sajë dhe te çele filiale ne te gjithë teritorin e Shqiperise.

## O B J E K T I

### Neni 7

Objekti I veprimtarise dhe aktiviteti I kesaje shoqerie tregtare private do te jete :

Ndertim-montim I objekteve te karaktereve dhe llojeve te ndryshme, import dhe export te lendeve te pare, materjaleve te ndertimit, makineri e paisje te ndryshme, te trajtimit te punetoreve, per tregtimin dhe prodhimin e artikujve me baze fibre, sintetike, xhami, hekuri, materjale inerte e ndertimi, artikuj industrial e ushqimor, bimeve medicinale, investime ne fushen e turizmit, hapjen e lokaleve te tregtimit, ndertimin e dyqaneve, sipermarrjeve te ndryshme, krijimin e filialeve te ortakerive brenda trasportit.

Si dhe çdo aktivitet tjeter qe vecmas ose se bashku me ato te perdorure me siper do te kosiderohen te pershtatshme per rritjen dhe zhvillimin e shoqerise.

## A F A T I I S H O Q E R I S E

### Neni 8

Aktiviteti tregtar I shoqerise do te zhvillohet me nje afat te pacaktuar mbi 10 vjet.

### Neni 9

Shoqeria eshte e detyruar te mose ndryshoje destinacionin e sajë. Ndryshimi I destinacionit te veprimtarise ekonomike e financiare brenda dy vjetesh mund te behet me lejen e organeve kopetente perkatese.

## K A P I T A L I I S H O Q E R I S E

### Neni 10

Kapitali themeltar I shoqerise tregtare private me pergjegjesi te kufizuar "Vllaznia Ndertim" Sh.P.K. Burrel perbehet nga shuma 100.000 leke te depozituara ne Degen e Bankes Kombetare Tregtare Burrel.

### Neni 11

Trasferimi I kapitalit themelor duhet te vertetohet me akt noterjal. Shoqeria apo te tretet duhet te respektojne keto trasferime sapo ti behen te ditura asaje.



## Neni 12

Pjeset e kapitalit themelor jane te transferueshme ne rruge trashegimie. Ato mund t'u kalojne bashkeshorteve, paraardhesve dhe pasardhesve sipas ligjes.



## DREJTIMI ADMINISTRATIV

### Neni 13

Shoqeria tregtare "Vllaznia Ndertim" Sh.P.K. Burrel do te kete si administrator z. Martin Pjetri. Ortaket themelues te shoqerise kane ne kopetence te caktojne si administrator edhe persona te tjere te cilet nuk kane cilesine e ortakut

### Neni 14

Ortaket themelues kane ne kopetence :

- Te miratojne programin e shoqerise te hartojne raportin e administrimit te inventarit, llogarite vjetore te cilat hartohen brenda nje afati 6/mujor nga dita e mbylljes se vitit financiar.
- Vendosin per shperberjen e shoqerise.
- Vendosin per ndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve.
- Rregullojne mardhenjet e punesimit dhe te shperblimit brenda shoqerise.
- Sipas afateve ligjore shlyejne detyrimet ndaj organeve shteterore, personave juridik, vendas e te huaj etj.

## K R E U I II.

### MARDHENIET EKONOMIKO-FINANCIARE

### Neni 15

Shoqeria tregtare "Vllaznia Ndertim" Sh.P.K. Burrel mund te lidh kontrata me sektore shteteror dhe drejtperdrejt me tregun e lire si dhe me persona juridik e fizik, vendas e te huaj, sipas legjislacionit ne fuqi per export-import.

### Neni 16

Ne veprime kontratuale shoqeria "Vllaznia Ndertimi" Sh.P.K. Burrel perfaqesohet nga ortaket themelues z. Martin Pjetri e Arben Çela ose persona te tjere te autorizuar prej tyre.

### Neni 17

Te drejtat dhe detyrat qe rrjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per shoqerine dhe per punonjesit e saje.

### Neni 18

Sipas rregullave te percaktuara nga Ministria e Financave dhe akteve te tjera nenligjore, shoqeria pergjigjet per kontabilitetin fiskal, afatet e derdhjes se detyrimeve ndaj shoqerise, sigurimet shoqerore etj.

Sipas ligjeve te tatimit mbi fitimin percaktohen tatimet per veprimtarine tregtare te shoqerise.

Shoqeria ka te drejte te çele llogari prane bankave te vendit e te huaja ne shqiperi dhe te kryej veprimet e likujdimit ndermjet tyre.

### Neni 19

Per sigurimin e veprimtarise ekonomike kjo shoqeri ka te drejte te vetfinancohet ne leke ose valute te huaj.

### Neni 20

Shoqeria, shkembimin e monedhes Shqiptare ne monedhe te huaj e anasjelltas mund ta beje ne perputhje me kursin e caktuar nga Banka e Shtetit Shqiptar ose me tregun e lire te valutes.

### Neni 21

Te ardhurat nga veprimtaria private e shoqerise do te sigurohen sipas çmimeve qe cakton vete shoqeria. Çmimet dhe tarifat do te caktohen sipas kerkeses dhe ofertets.

### Neni 22

Per pasqyrimin e aktivitetit tregtar, administratori ose persona te tjere te caktuar nga ortaket themeluesjane te detyruar te mbajne dokumentacion te rregullt financiar dhe rregjistrat perkates sipas ligjit te veçante.

## KREU I III.

### MARDHENIET E PUNESIMIT

### Neni 23

Ortaket themelues te shoqerise per realizimin e veprimtarise saje marrin ne pune punonjes me kontrate pune vjetore dhe sezonale

Mardheniet e punesimit brenda shoqerise rregullohen sipas kontrates se lidhur lirisht midis paleve.



#### Neni 24

Punonjesit gezojne lejen vjetore dhe leje plotesuese sipas kriterëve te percaktuara ne kontraten e punes dhe ne mungese se saje sipas Kodit te Punes te Republikes se Shqiperise.

#### Neni 25

Ndryshimi dhe largimi nga vendi I punes behet ne baze te nje akti me shkrim te leshuar nga ortakët themelues z.Arben Çela dhe z.Martin Pjetri. Largimi lidhet me mbarimin e kontrates se punes, per shkak te shkeljeve disiplinore ose me kerkese te vete te interesuarit.

### KREU I IV.

#### BILANCI DHE TE ARDHURAT

#### Neni 26

Te ardhurat neto pas shlyerjes se detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqerore etj. kalojne ne pronesi te ortakëve themelues dhe ndahen sipas kontributit te seicilit.

#### Neni 27

Shperblimi per punonjesit e punesuar ne veprimtarine e shoqerise private "Vllaznia Ndertimi" Sh.P.K.Burrel caktohet sipas kontrates se punes. Ndryshimi ne page vendoset nga ortakët themelues te shoqerise.

### KREU I V

#### DISPOZITA TE FUNDIT

#### Neni 28

Ortakët themelues ne rastin e shtimit te numerit te ortakëve kane te drejte te bejne ndryshimet e nevojshme ne statut si dhe te hartojne kontraten e perbashket me ortakete tjere duke bere ndryshimet e nevojshme ne Rregjistrin Tregtar ne Gjykatën e Rrethit Tirane.

#### Neni 29

Maredheniet e shoqerise tregtare "Vllaznia Ndertimi" Sh.P.K.Burrel me persona juridik e fizik vendas e te huaj zgjidhen me mirekuptim ne te kunderten kur kjo nuk arrihet, zgjidhen nga Gjykata e Rrethit te Tiranes.



Neni 30

Per sa nuk eshte shprehur ne kete statut I referohet ligjit Nr. 7512 dt 10 Gusht 1991, Kodit Tregtar si dhe çdo akti tjeter ligjor te legjislacionit shqiptar.

Neni 31

Statuti pregatitet ne disa kopje per tju derguar organeve kopetente. Nje kopje e tije mbetet si pjese e dokumentacionit te formimit te shoqerise tregtare "Vllaznia Ndertimi" Sh.P.K. Burrel. Ky statut pasi lexohet nenshkruset ne burrel sot me date 27.12.1995

ORTAKET THEMELUES

ARBEN ÇELA      MARTIN PJETRI

*Arben Çela*  
Ky statut u pregatit nga une

Avokat HAJREDIN HYSA

AVOKAT  
Hajredin Hysa  
MAT

REPUPLIKA E SHQIPERISE  
NOTRE VJOLLCA SKENDO  
NR. 4708 Rep.  
Nr. 1840 Kol.

VERTETIM

Sot me date 29.12.1995 para meje noteres u paraqiten ortakët themelues z.Martin Pjetri e Arben Çela me banim ne qytetin e Burrelit madhor dhe me zotesi per te vepruar te cilet me paraqiten per vertetim Statutin e shoqerise tregtare "Vllaznia Ndertim" Sh.P.K. Burrel te hartuar jashte kesaj zyre te cilet deklaruan se eshte hartuar sipas vullnetit te tyre te lire e eshte nenshkruar prej tyre dhe une Noterja e vertetoj ate rregullisht sipas ligjes.

NOTERE  
VJOLLCA SKENDO



*[Signature]*